



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Emri i punës me dt.	15.04.2019
Zona e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-150

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. ref. _____

Datë: ____ / ____ / ____

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës dhe Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti" nr. 04-V-621, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 15.04.2019, mori vendim për të shpallur:

KONKURS

Për Rektor të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren

- Të ketë përvojën e dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkime shkencore dhe gradën, më së paku, të profesorit të asocuar.
- Të ketë përvojën e dëshmuar, menaxhuese universitare.

Kandidatët për rektor së bashku me kërkesë, duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Biografinë e shkurtër (CV-në);
- Certifikatën e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dëshminë nga gjykata mbi të kaluarën penale;
- Vendimin mbi thirrjen akademike (të noterizuar);
- Diplomat universitare për tri nivelet e studimit (të noterizuar);
- Dëshminë mbi përvojën akademike dhe menaxheriale në arsimin e lartë;
- Vizionin mbi menaxhimin katërvjeçar të universitetit.

Procedura e përzgjedhjes:

- Për pozitën e rektorit, konkurrimi është i hapur për stafin e brendshëm dhe të jashtëm;
- Zgjedhja e Rektorit bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës si dhe nenit 26 dhe 27 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti".

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë kandidatët pa asnjë lloj diskriminimi, të cilët i plotësojnë kriteret ligjore të parapara për këtë pozitë.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dorëzohen çdo ditë pune, sa është i hapur konkursi prej orës 9:00 – 15:30 në Zyrën e Personelit nr. 526, administrata qendrore; adresa: "Ruga e Shkronjave", pn. 20000, Prizren - Republika e Kosovës.

Aplikacioni i drejtohet Komisionit Profesional, të formuar nga Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren. Të gjitha dokumentet përveç në kopje fizike, dërgohen edhe në formë elektronike (të skanuara) në adresën: apliko.upz@uni-prizren.com.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në Ueb-faqen zyrtare të Universitetit, përkatësisht nga data 16.04.2019 deri më 30.04.2019.